



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



## **Raport**

Monitorim i sistemit të drejtësisë për përmbushjen e detyrimeve ligjore që vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës për prindërit kundrejt fëmijëve në Qarkun e Vlorës.

Prill 2018 - Janar 2019

Vlorë, Shkurt 2019

Ky publikim është realizuar në kuadër të projekti” Më tepër vëmendje” si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materjali është përgjegjësi e vetme e SEEP dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

## **Tabela e Lëndës**

Hyrja.....	i
Metodologjia e Monitorimit.....	ii
1. Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës.....	1 f.
1.1 Takimi me fëmijët.....	1 f.
1.2 Detyrimi Ushqimor.....	4 f.
2. Një proces i rregullt ligjor.....	7 f.
2.1 Avokatët.....	7 f.
2.2 Psikologët.....	8 f.
2.3 Gjyqtarët.....	8 f.
2.4 Përmbaruesit.....	11 f.
3. Aksesi në drejtësi.....	12 f.
4. Sugjerime.....	15 f.
Bibliografia.....	23 f.

## Hyrja

Organizata SEEP është krijuar në 22 Korrik të 2011 dhe ka për mision të përmirësojë jetën sociale dhe cilësinë e mjedisit duke ruajtur ekuilibrin midis njerëzve dhe natyrës. Qëllimi dhe objektivi i veprimtarisë së saj janë angazhimi solidar, i drejtëpërdrejtë dhe aktiv në drejtim të:

- Evidentimit të fëmijëve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Integrimin qytetar dhe komunitar të tyre;
- Krijimin e mundësive të diferencuara arsimimi, mundësi argëtimi, pjesëmarrje në punë mjedisore, në sporte dhe veprimtari të tjera, argëtuese, të gjitha këto me qëllim edukimi;
- Ndërgjegjësim dhe sensibilizim i shoqërisë civile për integrimin e këtyre grupeve.

Në mbështetje me institucione të tjera, SEEP ka realizuar një sërë aktivitetesh për realizimin e edukimit social të komunitetit. Në strukturën e saj, organizata SEEP ka departamentin e edukimit social, i cili merret aspektin juridik dhe social të problematikave.

Një rëndësi të madhe ka edukimi social i komunitetit, pasi një komunitet i informuar reflekton ndërgjegjësim dhe sensibilizim mbi çështjet që ka marrë informacion. Në saj të punës disa vjeçare, organizata SEEP ka ndërmarrë të bëjë sa me vizibël rëndësinë e një procesi të rregullt ligjor. Kur i referohemi kërkesës për një proces të rregullt ligjor, kërkohet vetëm zbatimi i procedurave nga ana e gjyqësorit. Ndërkohë që kur një vendim nuk është i ekzekutueshëm, nuk ka rëndësi se sa mirë është realizuar procedura para togave të zeza, kur ky vendim nuk sjell pasojat e tij. Pikërisht në realizimin e këtij monitorimi, SEEP ka bashkëpunuar me gjykatat dhe zyrat e përmbarimit, për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për pasqyrimin e situatës në Qarkun e Vlorës.

## Metodologjia

SEEP ka zbatuar projektin “Më tepër vëmendje” në periudhën prill 2018-mars 2019, në kuadër të projektit Në kuadër të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.. Për realizimin e këtij projekti, SEEP ka realizuar monitorime dhe anketim në Gjykatat e Qarkut Vlorë në një kohështrirje prej 50 ditësh, i cili është mbështetur financiarisht nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave të Integruara në kuader të projektit.

Nga monitorimet e realizuara janë monitoruar 110 seanca gjyqësore për një periudhe kohore prej 50 ditësh monitorim, ku 10 ditë janë realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, 30 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe 10 në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për realizimin e monitorimit është hartuar një procesverbal seance që është plotësuar nga monitoruesit. Qëllimi i realizimit të këtij monitorimi ishte për të konstatuar se kush janë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në mos realizimin e një procesi të rregullt ligjor. Me synimin për të paraqitur jo vetëm situatën problematike por për të nxjerr edhe sugjerime për rregullimin e situates.

Që në fillim të projektit, një avokat ka trajnuar monitoruesit për metodologjinë e monitorimit të seancave.

Ekspertet e SEEP hartuan anketat të cilat shërbyen për strukturimin e monitorimit, si dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit në përputhje të qëllimit të monitorimit. Monitorimi është realizuar edhe përmes anketimeve ku janë realizuar anketa me qytetarët, gjyqtarët, përmbaruesit dhe avokatët. 2500 anketa në total me qytetarët e Bashkise Vlorë, Sarandë, Selenice, Himare, Delvinë, Konispol dhe Finiq. Jane realizuar 15 anketa me gjyqtarë, 12 anketa me përmbaruesit dhe 300 anketa me avokatët. Të anketuarit janë gjyqtarët e seksionit familjar, avokatët që merren me zgjidhjen e martesave, përmbaruesi privat dhe ai shtetëror. Për anketimin e qytetarëve është pasur parasysh që të përfshihen zona të ndyshme të qytetit. Për secilin të anketuar është përgatitur nje anketë e veçantë, pra një anketë për gjyqtarët, një për përmbaruesët, një për avokatët dhe një për qytetarët.

Për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm kemi marrë dhe informacion statistikor në rrugë zyrtare nga Institucionet e Gjyqësorit dhe Zyrat Përmbaruese Shtetërore.

Monitorimi me anketat e gjyqtarëve, avokatëve, përmbaruesve dhe qytetarëve me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Shpërndarja e fletëpalosjeve në 7 komuna të Qarkut të Vlorës me qëllim të rritjes së qasjes në sistemin e drejtësisë. Transmetimi i publicitetit në vend që synon të edukojë qytetarët për të rritur qasjen në sistemin e drejtësisë. Një emision televiziv që synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve duke rritur qasjen në sistemin e drejtësisë

Për një realizim sa më të përshtatshëm dhe profesional të monitorimit, kryesisht realizimit të anketave brenda strukturës së institucioneve, SEEP ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha institucionet për të krijuar lehtësira në realizimin e punës së monitoruesve.

Ky raport përmbledh gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet parë nën një këndvështrim objektiv dhe të paanshëm, të udhëhequr nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me strukturat e

monitoruara, në respekt të punës së rëndësishme dhe voluminoze që realizojnë administrata e sistemit gjyqësor.

## **1. Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës**

Zgjidhja e martesës ka dhe pasojat e saj. Por jo gjithëmone ish –bashkëshortët arrijnë të kuptojnë se pavaresisht se nuk janë më bashkëshortë, do të vazhdojnë gjithë jetën të jenë prindër të fëmijëve të tyre. Arsyet e ndarjes së një çifti janë të shumta, por janë të ralla rastet kur ato realizohen me mirëkuptim dhe si pasojë e konfliktit që kanë bashkëshortët ndërmjet tyre, pala e humbur rezulton pala më e pambrojtur, që janë fëmijët. Gjetja e gjuhës së përbashkët është e vështirë edhe për çështjet më të rëndomta. Legjislatori ka parashikuar se zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe deyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijës së tyre.<sup>1</sup>

### **1.1 Takimi me fëmijët**

Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij.<sup>2</sup> E drejta e prindërve për ta takuar lidhet me zbatimin e një nga parimeve më të rëndësishme që duhen pasur parasysh në çështjet e zgjidhjes së martesës, parimi i interesit më të lartë të fëmijës.<sup>3</sup> Prandaj gjykata përcakton të drejtën e takimit me prindërit në banesë për të garantimin e këtij interesi.

Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës.<sup>4</sup> Gjkata në vendimin e saj merr parasysh që fëmija duhet të ruajë marrëdhënie vetjake të rregullta me prindërit, në rastin kur kemi mosmarrëveshje midis prindërve atëhere vendoset një kalendar takimesh, i cili duhet të respektohet nga të dyja palët. Kalendar i takimeve parashikon kryesisht fundjavën e javën e parë dhe të tretë ose fundjavën e dytë dhe të katërt të çdo muaji dhe 15 ditë në muajin Gusht në pushimet e verës dhe 15 ditë në pushimet e dimrit. Në përcaktimin e këtij kalendari i cili kryesisht është static<sup>5</sup>, nuk arrihet të garantohet realisht ruajtja dhe krijimi i këtyre raporteve duke qenë se në mjaft raste ka pasur edhe prindër që jetonin jashtë shtetit dhe

---

<sup>1</sup> Kodi i familjes neni 154

<sup>2</sup> Kodi i familjes neni 158

<sup>3</sup> Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situatë të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

<sup>4</sup> Ligji 18/2017 neni 9

<sup>5</sup> Referuar monitorimeve të seancave gjyqësore

nuk kishin mundësi reale të zbatimit të këtij kalendari. Prandaj në përcaktimin e kalendarit të takimeve duhet të shikohet situata reale për të garantuar këtë të drejtë prindërve dhe fëmijëve.<sup>6</sup> Në çështja Bajrami kundër Shqipërisë ku GJEDNJ shqyrton pikërisht rëndësinë e jetës familjare.<sup>7</sup>

Ka edhe raste kur gjykata konstaton se për interesin më të lartë të fëmijës nuk duhet lejuar ruajtja e këtyre marrëdhënieve pasi shkakton dëmim të zhvillimit fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.<sup>8</sup> Nga monitorimi konstatuam se fëmijët po përdoret si mjet për të manipuluar ish-bashkëshortët. Hakmarrja prindërore shkon deri në “rëmbimin civil të fëmijës” dhe privimin fëmijës dhe të prindërit tjetër nga kontaktet dhe marrëdhëniet.<sup>9</sup> Nga monitorimet e kryera në Qarkun e Vlorës, nga projekti kemi konstatuar se të pakta janë rastet kur çiftet vazhdojnë të mbajnë një raport të mirë për hir të fëmijës, vetëm 27.24% e të anketuarve mbanin marrëdhënie të mira me ish-bashkëshortin për hir të fëmijës. Në takimet e fëmijëve mbetet problematike manipulimi që iu bëhet fëmijëve nga prindërit me të cilët jetojnë, duke i ushqyer me urrejtje për prindin tjetër<sup>10</sup>.

---

<sup>6</sup> Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

- a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;
- b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;
- c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;
- ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;
- d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;
- dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;
- e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.


<sup>7</sup> Çështja Bajrami kundër Shqipërisë: 50. Gjykata rithekson se qëllimi kryesor i nenit 8 është të mbrojë individin prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike. Përveç kësaj, ka detyrime pozitive të qenësishme për “respektimin” efektiv të jetës familjare. Në të dy kontekstet duhet të ketë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi; dhe në të dy kontekstet shteti gëzon një liri të caktuar vlerësimi (shih Keegan v. Ireland, vendimi i datës 26 maj 1994, Seria A nr. 290, f. 19, § 49; Ignaccolo-Zenide v. Romania, no. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I; Iglesias Gil and A.U.I. v. Spain, no. 56673/00, § 49, ECHR 2003-V; and Sylvester v. Austria, no. 36812/97, 40104/98, § 51, 24 April 2003).

51. Përsa i përket detyrimit të shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka arsyetuar vazhdimisht se neni 8 përfshin të drejtën e prindit në marrjen e masave me qëllim ribashkimin e tij me fëmijën dhe detyrimin e organeve shtetërore për të lehtësuar këtë ribashkim (shih, ndër autoritetet e tjera, Ignaccolo-Zenide, e përmendur më sipër, § 94; Iglesias Gil dhe A.U.I., e përmendur më sipër, § 48; dhe Nuutinen v. Finland, nr. 32842/96, § 127, ECHR 2000-VIII).

<sup>8</sup> Ligji 18/2017 neni 9/4

<sup>9</sup> Arta Mandro, *Revista Avokatia* 6, 2013, Tirane, f 115

<sup>10</sup> Sipas Permbarrimit Shtetëror Vlore



**Tabela 1. Të dhëna statistikore mbi raportet që ruajnë ish-bashkeshortet nga monitorimet**

Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar të qetë dhe të qëndrueshëm nga çdo pikëpamje, ku të gjithë pjesëtarët e tij të shfaqin një frymë tolerance dhe bashkëpunimi, në mënyrë që cilido prej tyre të ketë më pas një personalitet të qëndrueshëm dhe një shëndet mendor të mirë.<sup>11</sup>

Arsyet e mosruajtjes së një raporti të mirë me ish-bashkëshortin janë<sup>12</sup>:

- 1 Për shkak të mentalitetit, të kulturës;
- 2 Janë larguar jashtë shtetit dhe nuk ruajnë më marrëdhënie me fëmijën ose kanë krijuar familje tjetër.
- 3 Për shkak të ndërhyrjes së familjareve të familjeve të origjinës vazhdojnë të kenë konflikte;
- 4 Mos dhënia e detyrimit ushqimor të fëmijës
- 5 Nuk kanë ruajtur marrëdhënie të mira bashkëshortët që janë ndarë për shkaqe që lidhen me përdorimin e dhunës në familje, bixhozit, alkoolit, të cilët prirën të mbeten në situatë konfliktuale për një kohë të gjatë edhe pas zgjidhjes së martesës në raport me çiftet që ndahen për arsye të tjera.
- 6 Për shkak të mospërputhjes së karaktereve;
- 7 zemërimin që kanë me ish-bashkëshortin ua percjellin fëmijëve dhe nuk janë të përgjegjshëm për mirëritjen e tyre

<sup>11</sup> Denisa Daka, *Revista Avokatia* 12, 2017, Tirane, f 79

<sup>12</sup> Analiza e monitorive të bera nga organizata SEEP



8 konflikte për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore

9 Kur janë ndarë për shkak të tradhtisë.

Megjithatë nga monitorimi i kryer arritëm të konstatojmë se me zgjidhjen e martesës merrte fund edhe jeta familjare për 64.6% të të anketuarve në Qarkun e Vlorës, ku u anketuan 2500 persona. Sipas tyre familja tradicionale nuk ekzistonte më dhe fëmija me dy prindër të ndarë nuk është më familje.

## 1.2 Detyrimi ushqimor

Një ndër përgjegjësitë prindore pas zgjidhjes së martesës është edhe pagimim i detyrimit ushqimor. Çdonjëri prej ish-bashkëshortëve është i detyruar t'i japë tjetrit të dhëna të sakta për pasurinë dhe të ardhurat e tij, kur ato janë të nevojshme për të caktuar detyrimin për ushqim. Me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, punëdhënësi, organet financiare përkatëse, zyrat e tatimeve dhe çdo organ tjetër ku mund të merren prova, janë të detyruar të japin gjithë informacionin e nevojshëm për gjendjen pasurore të ish-bashkëshortit tjetër dhe për të gjitha të ardhurat e tjera të tij.<sup>13</sup> Ndonëse ligji e ka të parashikuar në praktikë shumica e avokatëve vetëm dorëzojnë certifikatat familjare dhe personale të çiftit dhe nuk ndër marrin asnjë masë për të marrë informacion të detajuar nga institucionet përkatëse, mbi të ardhurat e çiftit që të kontribuojë në përcaktimin sa më të saktë të detyrimit ushqimor për fëmijën duke mos operuar në interesin më të lartë të fëmijës, gjë që sjell si pasojë mospërcaktimin e duhur dhe të saktë të masës së detyrimit për ushqim për prindin që nuk jeton me fëmijën dhe që duhet të paguajë. Një pjesë e pakët e avokatëve dorëzojnë prova shkresore mbi të ardhurat që disponojnë palët, pasi pjesa më e madhe deklarojnë përpara gjyqtarit gjendje ekonomike të palëve të pa bazuar në asnjë provë shkresore.

Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësive me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj.<sup>14</sup> Në konstatimet e bera rezultoi që nuk janë të gjithë prindërit të përgjegjshëm kundrejt detyrimeve të tyre ndaj fëmijëve, pasi 57.16% prej tyre nuk paguajnë detyrimet ushqimore. Sipas të dhënave nga zyrat përmbarimore shtetërore dhe private, më pak se 50% e prindërve paguajnë detyrimet ushqimore vullnetarisht.

---

<sup>13</sup> Kodi i familjes neni 162

<sup>14</sup> Protokollu 7 i konventës për të drejtat e njeriut neni 5




Tabela 2 Të dhëna mbi statistikën e pagesës së detyrimeve ushqimore<sup>15</sup>





Tabela 3 Të dhëna mbi qëndrueshmërinë e pagesës së detyrimit ushqimor<sup>16</sup>

<sup>15</sup> Të dhëna të nxjerra nga anketimet e kryera me qytetarët

<sup>16</sup> Të dhëna të nxjerra nga anketimet e kryera me qytetarët



Ndër arsyet e mos pagimit të këtyre detyrimeve nga ana e prindërve janë<sup>17</sup>:

1. Paaftësia ekonomike që kanë duke qenë të papunë;
2. kur nuk mbajnë më marrëdhënie me fëmijën;
3. Për shkak të konflikteve të ish- bashkëshortes, ose konflikti i zgjidhjes së martesës
4. Perceptimi se kjo pagesë do të përdoret nga ish-bashkëshortja.

Qytetarët nuk kanë njohuritë e duhura ligjore dhe presin që vendimi të ekzekutohet vetë në kohën kur duhet ta paraqesin në zyrat e përmbarrimit dhe nuk mund të kërkojnë më shumë se 6 muaj detyrim të prapambetur ndërkohë, në kërkesat e tyre për ekzekutim kërkojnë nga momenti i marrjes së vendimit.

<sup>17</sup> Të dhëna të nxjerra nga anketimet e kryera me përmbauruesit dhe qytetarët

## 2. Një proces i rregullt ligjor

Një nga kushtet që të kemi drejtesi nga sistemi i gjyqësorit është pasja e një procesi të rregullt ligjor. Kur flasim për një proces të rregullt ligjor nuk i referohemi vetëm zbatimit të të gjithave procedurave në seancë gjyqësore, por edhe ekzekutimit të vendimit.<sup>18</sup> Pasi në momentin që një vendim gjyqësor i cili nuk është i ekzekutuar, është njësoj sikur ky vendim të mos ekzistonte. Nga monitorimi që organizata SEEP bëri në kuadër të projektit “Më tepër vëmendje” arriti të konstatonte disa probleme të cilat prekin zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të vecanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.<sup>19</sup> Por gjykata e Sarandës nuk ka gjithë infrastrukturën e duhur për të garantuar një proces të hapur pasi një nga sallat e saj ka përmasat e një zyre. Nëse në gjykatat e tjera të vendit është problem fakti që seancat zhvillohen në zyrat e gjyqtarit, salla në fjalë është në përmasat e një zyre duke sjell vështirësi në realizimin e një procesi me dyer të mbyllura me pjesëmarrjen e të gjithë palëve për shkak të hapësirës së pamjaftueshme. Në seancat e pajtimit të cilat palët i kanë kërkuar t’i zhvillojnë me dyer të mbyllura për shkak se nga kjo sallë është e mundur aksesimi në arkive apo në zyrën e IT konstatuam se nuk zbatohet kjo e drejtë e palëve, pasi gjatë zhvillimit të seancave të pajtimit, personeli i gjykatës lëvizte lirshëm në këtë sallë. Një nga sallat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka kushtet teknike për tu quajtur sallë, ka përmasa të vogla dhe nuk ka sistem ajrimi.

### 2.1 Avokatët

Avokatët nuk garantojnë një proces të rregullt ligjor pasi, puna e tyre përfundonte me përfundimin e procesit gjyqësor duke i mos ndjekur çështjen në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, pasi përfaqësimi i tyre nuk përfshin deri në ekzekutimin e vendimeve, por vetëm përfaqësimin në gjykatë. Puna e avokatëve kryesisht përqëndrohet në zgjidhjen e martesës e jo në sigurimin e interesit më të lartë për fëmijën, duke qenë se flasim për një proces ku palët janë shumë të përfshira emocionalisht në proces dhe nuk janë aq objektive për të garantuar këto të drejta për fëmijët. Avokatet si palë e jashtme bëjnë shume pak përpjekje për garantimin e këtij parimi. Dokumentat që dorëzojnë në këto raste janë vetëm çertifikatat familjare të paleve dhe pavaresisht se ligji u njeh të drejtën të marrin të gjitha të dhënat për të ardhurat që disponojnë

---

<sup>18</sup> Çështja Qufaj Co.sh.p.k. kundër Shqipërisë [Cm/Resdh(2011)86]

<sup>19</sup> Neni 6 I KEDNJ

palët për përcaktimin sa më të drejtë të detyrimit ushqimor të fëmijës, kjo gjë nuk zbatohet.<sup>20</sup> Avokatet duhet të realizojnë një analizë të fakteve paraprake për të arritur në një zgjidhje me mirëkuptim dhe në interesim më të lartë të fëmijës. Pra, avokatet duhet të jenë filtri i parë i cili do të mundohet tu ofrojë asistencë ligjore për zgjidhjen e çështjes me marrëveshje ose ndërmjetësim. Gjithashtu, avokatët e përdorin shumë pak aktmarrëveshjen pasi kostot financiare për një zgjidhje martese rriten për palët dhe gjykata edhe në rastin kur ato realizohen e zhvillojnë procesin njësoj si të mos kishte asnjë aktmarrëveshjeje. Në asnjë nga rastet e monitoruara, avokatët nuk kanë kërkuar që çështja të zgjidhet me ndërmjetësim.

Sot po zhvillohet një trend i ri ku psikologë dhe avokatë ndajnë të njëjtën zyrë për arsye financiare. Ajo që vërehet më pas në rastet e zgjidhjeve të martesave është se këta avokatë kërkojnë që psikologe të caktohet kolegia e zyrës, duke vënë në dyshim paanësinë e psikologes në punën që ajo zhvillon duke qenë se në këto raste kemi të bëjmë me një konflikt interesi.

## 2.2 Psikologët

Psikologët që punojnë pranë sistemit të drejtësisë janë të përcaktuar me urdhër nga urdhri i psikologut dhe janë të trajnuar për punën e tyre. Jo çdo psikolog mund të përfshihet në proceset gjyqësore si asistues apo vlerësues.. Konstatuam se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kishte edhe raste kur psikologja që paraqitej në seancat gjyqësore nuk ishte e pajisur me licencën e psikologut. Gjithashtu në të dyja gjykatat punonin psikologë të cilët nuk ishin përcaktuar nga urdhëri i psikologut për të punuar pranë sistemit të drejtësisë pasi nuk janë trajnuar për këtë pozicion.. Raportet e vlerësimit psikologjik lënë për të dëshiruar në cilësinë e tyre, në sa ato i përgjigjen pyetjeve që drejton Gjykata dhe kjo konstatohet sidomos në çështje të një ndjeshmërie të lartë siç janë urdhrat e mbrojtjes, ku raportet shpesh janë krejt të ngjashme me njëra tjetrën. Sot psikologët veprojnë si një biznes i legjitimuar duke qenë se janë të domosdoshëm për një proces të rregullt ligjor, por nuk ka asnjë kontroll për cilësinë e punës së tyre. Një shqetësim gjithashtu i madhë është dhe paanësia e raportit të ekspertit në momentin që gjykata e vendos si shpenzim vetëm për njerën palë dhe jo si shpenzim i përbashkët. Ndonëse në Kodin e Procedurës Civile parashikohet se eksperti parapaguhet nga pala paditëse për të garantuar një paanësi dhe për të mos krijuar konflikt midis palëve, duhet të parashikohet në legjislacion që shpenzimet e ekspertit të paguhet nga të dy palët. Në momentin që ky ekspert paguhet drejtëpërdrejtë vetëm nga njëra palë sa asnjëanëse do të jetë ajo në raportimin që do të bëjë kur kontraktohet për të dhënë një vlerësim për palën që e paguan.

## 2.3 Gjyqëtarët

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Sarandës nuk ka një seksion për çështjet familjare për shkak të numrit të vogël të gjyqëtarëve që kjo gjykatë ka dhe për rrjedhim të gjithë gjyqëtarët shqyrtojnë të gjitha çështjet. Në fillim të seancës disa nga gjyqëtarët e Gjykatës së Rrethit Sarandë u ofronin palëve zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim, ndonëse palët nuk pranonin dhe çështja kalonte për

---

<sup>20</sup> Kodi i familjes neni 162

gjykim, kurse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlore kjo procedure nuk zbatohet. Gjyqëtarët në punën e tyre të përditëshme përcaktojnë 1 apo 2 psikologë të cilët janë të përherëshëm në sallën e tyre dhe nuk i referohen aspak listës së psikologëve, pasi thërrasin psikologë që nuk janë në listën e vënë në dispozicion nga urdhëri i psikologjëve. Vendimet e gjykatave merren mbi bazën e provave të pakta që u vendosen në dispozicion.

Në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar që afati maksimal i zgjatjes së një procesi gjyqësor mund të jetë deri në 1 vit.<sup>21</sup> Gjatë kësaj kohe që zgjatet procesi çifti jeton i ndarë dhe fëmijët jetojnë vetëm me njërin prind. Nga monitorimet kemi konstatuar se në momentin e vendimmarrjes për të zgjidhur martesën, jo vetëm shkëputen marrëdhëniet bashkëshortore, por nuk përmbusheshin as detyrimet prindërore, duke mos kontribuar në mirërritjen e fëmijës/ve dhe në takimin e fëmijës. Pavarësisht se palët deklarorin në seancë gjyqësore se nga momenti që kishin vendosur të zgjidhnin martesën një nga bashkëshortët ishte larguar nga banesa, dhe kishte kohë që nuk shikonte fëmijët dhe nuk kishite kontribuar në mirërritjen e fëmijëve, as nga ana e avokatëve nuk kërkohej marrja e një mase të përkohshme të menjëherëshme qoftë për detyrimin ushqimor as për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive prindërore në interesin e fëmijës për të vazhduar t'i siguruar të njëjtën nivel jetese dhe marrëdhënie me prindërit, por as nga gjykata nuk ka një predispozitë për një ndërhyrje të tillë. Kjo bën që për fëmijën të kujdeset vetëm njëri nga prindërit deri në daljen e vendimit gjyqësor dhe kërkimit të ekzekutimit të tij të detyrueshëm. Gjykata ka në bazë të ligjit detyrimin për të vendosur detyrimin ushqimor dhe në mungesë të një të dhëne të saktë si p.sh. Se sa janë të ardhurat që kanë palët, i referohen pagës minimale duke përcaktuar detyrimin ushqimor në masën e 1/3 të pagës minimale. Gjykata si palë ekuilibruese duhet të shikojë dhe të analizojë të gjitha rrethanat e çështjes dhe të kërkojë edhe prova shtesë për të garantuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Përsa i përket vendimeve të gjykatës ato janë pothuajse identike, pavarësisht se kemi raste të ndryshme dhe situata të komplikuar. Në rastet kur gjykata merr informacionin se zgjidhja e martesës po vjen si pasojë e dhunës në familje ose ka dhunë në familje nuk përcakton masa të ndryshme nga një zgjidhje martesë me mirëkuptim duke mos caktuar monitorimin e rastit dhe të takimeve me fëmijën, të cilat duhet të monitorohen nga shërbimi social (njësia e mbrojtjes së fëmijëve) dhe të asistohen gjatë gjithë procesit të nevojshëm që të ketë siguri që fëmija nuk po vihet në rrezik. Nuk ka asnjë dallim në vendimet e Gjykatës në mënyrën e takimit midis prindërve të cilët kanë nevojë për asistencë për shkak se janë të dhunshëm, janë konsumator të alkoolit apo drogave dhe prindërve të tjerë të cilët nuk paraqesin problematika të tilla.

---

<sup>21</sup> Kodi i Procedurës Civile afati i kohëzgjatjes së çështjeve




Tabela 4. Të dhënat mbi shumat e detyrimit ushqimor.<sup>22</sup>

Gjithashtu emigrimi është një faktor normal në shoqërinë e sotme por në asnjë rastë të monitorimit nuk konstatuam që takimet me fëmijët të ishin të ndryshme për prindërit që jetojnë brenda territorit të Shqipërisë dhe atyre që jetojnë jashtë, kryesisht takimet lihen fundjavën e parë dhe të tretë ose të dytë dhe të katërt dhe 15 ditë në pushimet e verës dhe 15 ditë në pushimet e dimrit. Pra nuk ka një ndryshim në përcaktimin e takimit të këtyre prindërve të cilët nuk do të mund të realizojnë këto takime në kalendarin e përcaktuar si dhe nuk parashikohet asnjëherë që për prindërit që jetojnë jashtë të mbajnë kontakte me fëmijët nëpërmjet rrugëve të komunikimit elektronik. Në vendimin e përcaktimit të detyrimit ushqimor nuk përcaktohen asnjëherë rastet e nevojave të jashtëzakonshme për rastet e sëmundjeve që kërkojnë shpenzime specifike që nuk mbulohen dot nga detyrimi ushqimor.

Në trajnimet e kryera nga shkolla e magjistraturës për gjyqtarët për tre vitet e fundit, numri i gjyqtarëve në këto trajnime ka qenë i ulët.

Tabela 5 trajnimet e gjyqtareve

Viti	Temat e trajnimit		Nr. i gjyqtareve qe u ftuan te marrin pjese	Nr. i gjyqtareve qe morren pjese ne trajnim
2016	1	Kuadri ligjor mbi te drejtat e grupeve te marginalizuara me fokus tek grate dhe vajzat.	5	1
	2	Kuadri ligjor mbi te drejtat e grupeve te marginalizuara me fokus tek grate dhe vajzat.		

<sup>22</sup> Të dhëna të nxjerra nga anketimet e kryera me përmaburuesit dhe Gjyqtarët

	3	Te drejtat e viktimes dhune famoljare dhe roli e nderveprimi i mekanizmit referues me focus te vecante gjyqetaret dhe prokuroret.		
	4	Instituti i kujdestarise, Roli dhe rendesia e familjes kujdestare, caktimi I kujdestarise dhe familja kujdestare. Roli i gjyqetarit dhe autoriteteve te tjera		
2017	1	Te drejtat e jetes private dhe familjes ne kesndveshtrim te nenit 8 te KEDNJ dhe problematikat Shqipatre	10	2
	2	Kujdestaria alternative me baze familjen		
2018	1	Jurispudenca e GJEDNJ-se ne zbatim te nenit 8 te KEDNJ mbi te drejten per jeten private dhe familjen	5	1
	2	Shkenca dhe ligji. Llojet e ekspertizave dhe roli i ekspertit ne procesin gjyqesor familjar etj.		
	3	Mbrojtja nga dhuna ne familje ne aspektin civil dhe penal		
	4	Mbrojtja nga dhuna ne familje ne aspektin civil dhe penal		
	5	Kujdestaria alternative me baze familjen		

## 2.4 Përmbarduesit

Përmbarduesit hasin vështirësi në ekzekutimin e vendimeve për shkak se:

1. Adresa jo të plota dhe të dhëna jo të sakta të debitorit, të cilat vështirësojnë marrjen e detyrimit ushqimor, vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme dhe llogarinë bankare;
2. Vështirësi në realizimin e takimeve dhe pagimin e detyrimeve ushqimore në rastet kur prindërit jetojnë jashtë shtetit;
3. Vështirësi në ekzekutimin e vendimeve ndaj prindërve të cilët nuk kanë të ardhura në bankë dhe pronësi të paluajtshme;
4. Deklarimi i prindërve debitor si të papunë.

Në momentin që një qytetar zhvillon gjithë procesin por nuk arrin të bëjë ekzekutimin e tij, atëherë është njësoj sikur të mos e kishte bërë këtë proces pasi ai nuk arrin të marrë drejtësi.



Mos ekzekutimi i vendimit nga ana e përmbaruesit sillte shkeljen e një procesi të rregullt ligjor dhe puna e përmbaruesit ka një rol të rëndësishëm, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me ekzekutimin e një vendimi por më të drejtën e jetës së një fëmije. Nga të dhënat statistikore të Zyrës Përmbarimore Vlorë, 20% e vendimeve mbeten të pa ekzekutueshme nga vetë përmbaruesi, ndërsa nga të dhënat e Zyrës Përmbarimore Sarandë mbeten pa u ekzekutuar 30% të detyrimeve për ushqim. Problematike vazhdon të mbetet fakti që ky detyrim mund të ekzekutohet në fillim me ndërhyrjen e përmbaruesit, por më vonë ato nuk ekzekutohen për arsye të ndryshme, duke bërë që të vazhdojë gjendja problematike.<sup>23</sup>

### 3. Aksesi në drejtësi

Ligji garanton që personat që nuk kanë mundësi të përfitojnë këtë ndihmë falas<sup>24</sup>. Ligji ka të parashikuar ndihmën për kategori të veçanta<sup>25</sup> por edhe për personat me paaftësi ekonomike<sup>26</sup>

---

<sup>23</sup> Sipas Zyres Përmbarimore Vlore.

<sup>24</sup> Ligji 111/2017 për ndihmën juridike falas

<sup>25</sup> Neni 11 i ligjit 111/2017 Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

a) viktimave të dhunës në familje;

b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;

ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullneshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;

f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>26</sup> Neni 12 i ligjit 111/2017 Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

2. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

për të përfituar këtë ndihmë. Në Gjykatat e Qarkut Vlorë nuk ka një zyrë për ofrimin e këtij shërbimi, duke bërë që kjo e drejtë të garantohet vetëm në letër. Nga monitorimi i kryer rezulton se njohuritë juridike të palëve, pavarësisht se ligji e garanton mbrojtjen vetë, u konstatua se qytetarët nuk kanë njohuritë e duhura juridike për tu mbrojtur edhe në këto seanca të thjeshta. Të gjitha palët që mbroheshin vetë në shumicën e rasteve nuk dinin si të komportohen në një seancë gjyqësore. Ndonëse e kërkojnë vetë zgjidhjen e martesës, ta nuk dinë si të kërkojnë pasojat e saj. Ligji për ndihmën juridike falas parashikon kategoritë dhe kushtet që duhet të plotësojë një person për të përfituar nga kjo ndihmë por kjo nuk është e realizueshme, pasi nuk ka zyra në çdo qytet duke mos e bërë funksionale këtë ndihmë. Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të komunitetit dhe kjo bëhet shkak për një mbrojtje jo të mirë. Për të realizuar “barazinë e armëve”, gjykata ndërhyr duke i bërë pyetje specifike palës për atë çfarë kërkon duke e orientuar për të kërkuar të drejtën e tij.




Tabela 6. Të dhëna mbi njohurinë mbi ndihmën juridike falas.

Nga monitorimet me avokatët konstatuam se kishte raste kur vetë avokatët nuk dinin se çfarë është ndihma juridike parësore dhe dytësore.

Ligji parashikon gjithashtu ofrimin edhe të ndihmës psikologjike falas<sup>27</sup> por nuk është marrë asnjë masë se si do të ofrohet kjo ndihmë, kur ajo ofrohet vetëm nga psikologë që punojnë pranë gjykatave si persona fizik të pavarur. Në kushtet kur këto shërbime që garantohen nga

4. Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

<sup>27</sup> Ligji 18/2017 Per te drejtat dhe mbrojtjen e Femijes

ligji nuk ofrohen nga shteti por mbeten thjeshtë në letër është njësoj si të mos ekzistonin. Kjo e drejtë ofrohet për t'i garantuar fëmijës, në çdo proces administrative dhe gjyqësor, realizimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.<sup>28</sup> Ka pasur raste kur personat nuk kanë pasur të ardhura për të paguar psikologun dhe është bllokuar procesi gjyqësor i zgjidhjes së martesës, pasi nuk ka qënë e mundur të zhvillohej një proces i rregullt ligjor. Për palët të cilët nuk kanë të ardhura për të paguar psikologun duhet të parashikohen me ligji që ai të paguhet nga shteti ose të ofrohet nga psikologët që punojnë pranë gjykatave duke përfituar lehtësime fiskale.

Proceset familjare kanë një dinamikë që nuk e gjejmë në rastet e tjera, pasi në këto seanca nuk ka një vendim përfundimtar, por çdo vendim i tyre është i ankimeshëm në çdo kohë kur kemi ndryshim të rrethanave të të ardhurave pasurore të palëve. Në Gjykatën e Apelit më së shumti paraqiten rastet kur ka kundërshtime me masën e detyrimit ushqimor pasi pretendohet se pala tjetër ka më tepër të ardhura nga çfarë ka deklaruar, ose për ndryshimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Rastet më të shumta janë për shkak të detyrimit të takimit me prindërit që nuk jetojnë apo me marrjen e kujdestarisë pasi kanë problematikën për të takuar fëmijët e tyre, të cilëve nuk ju lejohet dhe shpesh përdoren si masë kërcënuese për pagimin e detyrimit ushqimor. Në rastet kur prindi nuk paguan nuk ka dhe të drejtë të takojë fëmijën sipas arsyetimit të disa të anketuarve.

---

<sup>28</sup> Neni 29 i ligjit 18.2017 E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor

1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.
2. Ndihma juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.
3. Ndihma juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor.
4. Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.
5. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacionit në fuqi.
6. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

#### **4. Sugjerime:**

1. Duhet të ashpërsohen masat ndëshkuese për prindërit të cilët nuk paguajnë detyrimet ushqimore, pasi vendosja e gjobave nuk është efektive. Në ligj duhet të parashikohen forma shtrënguese të tjera për të garantuar ekzekutimin e detyrimeve ushqimore si psh. burgim; ose masa ndëshkuese si psh. punë publike dhe pagesa që duhet të merrte një prindi për këtë punë ti jepet fëmijes etj.
2. Duhet ofruar Ndhimë sociale shtetërore për kategorinë e prindërve të divorcuar që duhet të paguajnë detyrimin ushqimor dhe nuk kanë të ardhura, duke garantuar ofrimin e një ndihme sociale që do të jetë për të garantuar pagimin e detyrimit ushqimor;
3. Prioritete punësimi nga zyrat e punësimit për prindërit e divorcuar që duhet të paguajnë detyrimin ushqimor dhe nuk kanë të ardhura, të cilët duhet ti shikojnë me përparësi në stategjit e tyre të punësimit;
4. Të parashikohet një sistem për marrjen e detyrimit ushqimor prindërve që jetojnë jashtë shtetit nëpërmjet kërkimit të adresave dhe vendodhjes në mënyrë që përmbaruset të kenë të drejtë të kërkojnë adresën brenda dhe jashtë shtetit.
5. Të merren masa për legalizimin e aseteve të qytetarëve, pasi informaliteti ndikon në mos ekzekutimin dot të vendimeve të gjykatës nga përmbaruesit;
6. Psikologu duhet të funksionojë si dhoma e avokatisë, jo vetëm për ato raste kur ofrohet kryesisht nga gjykata, por edhe në çështjet e zgjidhjes së martesës duket të parashikohet me ligji që ai të paguhet nga shteti ose të ofrohet nga psikologët që punojnë pranë gjykatave duke përfituruar lehtësime fiskale, për palët që kanë paaftësi paguese;
7. Gjykata të vendosë edhe për monitorim të çështjes nga shërbimet sociale shtetërore në ratet kur konstaton se zgjidheja e martesës ka ardhur për shkaqe që lidhen me përdorimin e dhunës në familje, bixhozit, alkoolit, të cilët priren të mbeten në situatë konfliktuale për një kohë të gjatë, për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës;
8. Në takimet me prindërit që realizohen nga përmbaruesi duhet të jetë i pranishëm edhe psikologu, i cili mund të jetë një nga psikologët që punon pranë gjykatave për të përfituruar lehtësime fiskale ose nëpunës i shërbimeve sociale me qëllim monitorimin e takimeve në rastet e zgjidhjeve të martesës problematike, për të garantuar interesim më të lartë të fëmijës;
9. Mënyra e funksionimit të përmbarimit duhet të ndryshojë për çështjet e ekzekutimit të detyrimit duke patur në qendër interesin më të lartë të fëmijës dhe faktin e domosdoshmërisë dhe një afati të menjëhershëm të vendimit. Të zbatohet afatet në kohe sa më të shpejta pasi zgjatja e ketyre afateve nxit dhe përkeqësimin e marrëdhënieve ish-bashkëshortore.
10. Përmbarimi duhet të këtë ambiente të posaçme për të realizuar takimet fëmijë-prind në mënyrë që të mos i shkaktojë fëmijës trauma.
11. Gjykata në rastin e marrëveshjeve për zgjidhjen e martesës, të vlerësoj dhe të marrë në konsideratë me përparësi marrëveshjen, të analizojë përputhshmërinë e saj me ligjin,

garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve që të sjell përfundimin e procesit sa më shpejtë.;

12. Noterët të përpilojnë marrëveshje në përputhje me ligjin;
13. Duhet të vendoset një minimum jetik dhe të përcaktohet një formulë për përlogaritjen e detyrimit ushqimor për fëmijën në stadi të ndryshme të jetës së tij. Nevojat e një fëmije janë të ndryshme në stadi të ndryshme të jetës së tij dhe nuk mund të jetë e njëjtë masa e detyrimit ushqimor si për një të porsalindur me një fëmijë që frekuenton shkollën në rastin kur prindërit e tyre kanë kushte të njëjta ekonomike; Vendosja e minimumin jetik do të ndihmojë dhe përcaktimi i një shume referuese për caktimin e kostave financiar që kanë fëmijët në periudha të ndryshme të zhvillimit të tyre do të ndihmojë dhe gjyqtarët në përcaktimin sa më të saktë të detyrimit ushqimor duke ju referuar gjithëmonë edhe të ardhurave ekonomike që palët disponojnë.;
14. Duhet të realizohen trajnime të detyrueshme me kredite për tu frekuentuar si nga gjyqtarët, avokatët, përmbartuesit dhe psikologët pasi nga monitorimi i kryer kontaktuar se e kanë të nevojshme trajnimet për përmirësimin e performancës në punën e tyre, për garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, e cila nuk zbatohet gjithmonë;
15. Duhet të ndërmerren masa për edukimin ligjor të popullsisë, pasi qytetarët duke mos pasur njohuritë e duhura ligjore shpesh here e keqinterpretojnë ligjin ose nuk e kuptojnë atë.

## Aneksi I

### Anketa e Gjyqëtarëve



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA  
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



**Save the Children**



Gjykata ku zhvillohet anketa \_\_\_\_\_

---

1-A mendoni se duhet të bëhet një ndarje për çështjet e seksionit familjar?

Po      Jo

2-Në çështje civile, zgjidhje martese kur çifti ka fëmijë palët mbrohen edhe vetë, por a kanë ata njohurit e duhura juridike për të kuptuar procesin dhe ti garantojnë vetës mbrojtjen më të mirë?

Po      Jo

3- Ka pasur ndonjë rast kur ndonjë nga palët ka kërkuar ndihmë juridike?

Po      Jo

4- Me ndryshimin e ligjit për ndihmë juridike a mendoni se duhet të bëhet një praktikë e mirë që individët që nuk ka gjendje të mirë ekonomike duhet tu ofrohet një ndihmë juridike që paleve t'u garantohet kontradiktorialitetit dhe armë të barabarta në një proces?

Po      Jo

5-Kërkesë paditë për zgjidhje martese kur palët kanë fëmijë janë të shoqëruara ndonjëherë me akt marrëveshje midis palëve?

Aspak      Disi      Shpesh      Gjithëmonë

6- A janë të shpeshta rastet kur kërkohet të ndryshohet masa e detyrimit ushqimor për shkak të ndryshimit të kushteve ekonomike të njërit prej prindërve?

Po      Jo

7- Sa është masa/ shumë që i caktohet një prindi për të paguar ndaj fëmijës si detyrim ushqimor?

100.00-150.00 lekë

150.00-200.00 lekë

200.00-250.00 lekë

Më pak \_\_\_\_\_

8- A mendoni se raporti midis pagës minimale dhe masës për detyrim ushqimor është i tillë që të garantoj ekzekutimin e detyrimit ushqimor?

Po      Jo

---

9- A kërkon gjykata informacione të mëtejshme për asetet pasurore që prindërit gezojnë përveç ato që deklarohen nga vete palët, në mënyrë që të jepet një shumë sa më e drejtë për pagimin e masës së detyrimit ushqimor?

Po      Jo

10- Për prindërit që janë të pa punë dhe nuk kanë të ardhura vendosje e masës për detyrim ushqimor që duhet të paguaj nuk bën që të kemi një drejtësi efektive?

Po      Jo

11 -A mendoni se duhet të bëhen ndryshime legjislative për të përmirësuar situatën për një proces të rregullt ligjor deri në ekzekutimin e vendimeve të detyrimeve ushqimore?

Po      Jo

12- Konkretisht çfarë ndryshimesh do të rekomandonit?

---

---

---

---

---

## Aneksi II

### Anketa e Përmbarduesve



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA  
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



**Save the Children**



Qyteti ku zhvillohet anketa \_\_\_\_\_

---

1-A mendoni se raporti i ish-bashkeshortëve ndikon në ekzekutimin e vendimeve të detyrimit ushqimor?

Po      Jo

2-Sa ndikon zgjatja e procesit në berjen me efektive të ekzekutimit të vendimeve të detyrimeve ushqimore?

Aspak      Pak      Disi      Shume

3-Legalizimi i aseteve mendoni se do të ndikoj në përmirësimin e situatës për një drejtësi sa më efektive? (përbushje të ekzekutimit të vendimeve të detyrimeve ushqimore)?

Po      Jo

4- Në çmasa bëhet ekzekutimi i vendimeve të detyrimeve ushqimore?

Aspak      Disi      Shpesh      Gjithmone

5-Detyrimi për takimet me prindrit a realizohen?

Po      Jo

A janë kushtet adeguata për realizimin e tyre?



Po Jo

6-A ekzistojne njohurite nga prinderit per detyrimin e zbatimit te vendimeve te detyrimet ushqimore ?

Po Jo

Ne sa raste vendimevet e detyrimeve ushqimore jane ekzekutuar vullnetarisht?

Aspak Disi Shpesh Gjithmone

7-A ndikon raporti i pages minimale dhe detyrimet per ushqim ne ekzekutimin e vendimit?

Po Jo

8-A jane te qendrushme pagimi i detyrimeve ushqimore nga prindrit ne kohe?

Po Jo

9-Per permbushjen e vendimit ekzekutim te detyrimeve ushqimore a merren te gjitha masat e nevojshme, deri ne konfiskim te kapitalit te paluajshem apo te luajtshem qe prindi mund te disponoj per ekzekutim te vendimit?

Po Jo

Jo,pse? \_\_\_\_\_

10-Ekzekutimi e vendimeve behet kryesisht nga palet apo veprimet kryhen nga avokati i paleve me prokure?

Palet Avokati

11- Sa eshte masa/ shuma e detyrimet per ushqim qe jepet?

100.00-150.00 leke 150.00-200.00 leke 200.00- 250.00 leke

12-Veshtiresite qe hasen ne ekzekutimin ne praktike te vendimeve?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

13- A mendoni se duhet te behen ndryshime legjislative per te permiresuar situaten per nje proces te reegullt ligjor deri ne ekzekutimin e vendimeve te detyrimeve ushqimore?

Po Jo

14- Konkretisht cfare ndryshimesh do te rekomandonit?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## Aneksi III

### Anketa e Avokatëve



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



Qyteti ku zhvillohet anketa \_\_\_\_\_

---

1-A mendoni se duhet të bëhet një ndarje për çështjet e seksionit familjar?

Po      Jo

2-A mendoni se duhet të bëhet një profilizim i avokatëve që merren me çështjet familjare?

Po      Jo

3- A kemi ofruar ndonjëherë ndihmë ligjore falas, për çështjet e detyrimeve ushqimore etj?

Po      Jo

Ndihma ka qenë a) ndihmë juridike Parësore

b) ndihmë juridike dytësore

4-Në çështjet kur pala tjetër nuk ka pasur avokat por është mbrojtur kryesisht, mendoni se është zbatuar parimi i kontradiktorialitetit dhe barazisë së palëve?

Po      Jo

5-Në çështjet e divorcit a keni bërë përpjekje paraprake për ta zgjidhur martesën me marrëveshje?

Marrëveshje + Kërkesë padi

Kërkesë padi

6-A zbatohet përmbushja e detyrimeve ushqimore nga palët?

Po      Jo

Pse jo? \_\_\_\_\_

7-Mendoni se kohëzgjatja e procesit bëhet brenda një afati i arsyeshëm kohë?

Po      Jo

Pse jo? \_\_\_\_\_

8- Në seancë a është e pranishme nëpunësja sociale apo psikologjia?

Po      Jo

9- Nga ekzperienca juaj profesionale, a realizohet parimi i dëgjimit dhe vlerësimit të thënieve të të mirurit nga psikologu?

Po      Jo

10 -A mendoni se duhet të bëhen ndryshime legjislative për të përmirësuar situatën për një proces të rregullët ligjor deri në ekzekutimin e vendimeve të detyrimeve ushqimore?

Po      Jo

11- Konkretisht çfarë ndryshimesh do të rekomandonit?

---

---

---

---

---

## Aneksi IV

### Anketa e Qytetarëve



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA  
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



**Save the Children**



Qyteti ku zhvillohet anketa \_\_\_\_\_

---

Gjinia.

M      F

Mosha.

>30 vjeç

>50 vjeç

> 70 vjeç

1-A ekziston jeta familjare pas divorcit?

Po

Jo

2- Keni lexuar apo jeni informuar ndonjëherë mbi të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësisë prindërore?

Po

Jo

3-A e dini se ekziston ndihma juridike falas? Nëse po a e keni përdorur ndonjëherë atë?

Po

Jo

4-Keni përdorur marrëveshjen për divorc, krahas zgjidhjes së martesës nëpërmjet kërkesës së padisë?

Po Jo

5-Jeni në marrëdhënie të mira me ish-bashkëshortin/partnerin për të vendosur mbi mirëritjen e fëmijës?

Po Jo

Pse jo?

---

---

6-A është asistuar fëmija gjatë procesit nga psikologjia apo nëpunësja sociale?

Po Jo

7- Sa ka zgjatur i gjithë procesi nga kërkesëpadia deri në ekzekutimin e tij?

---

8-I paguhen fëmijës detyrimet ushqimore nga prindi me të cilin ai nuk jeton?

Po Jo

-Këto pagesa janë të qëndrueshme apo sporadike?

---

---

9- A ndiheni se keni marrë drejtësi nga ky proces? (Ekzekutimin e vendimit)

Po Jo

10- Në seancë jeni mbrojtur vetë apo keni pasur avokat?

---

---

## **Bibliografia:**

Kushtetuta

Konverta Evropiane e te drejtave te Njeriut

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Konventa për ushtimin e të drejtave te fëmijëve

Protokolli 7 i Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut

Kodi familjar

Kodi Civil

Kodi i Procedures Civile

Ligji 111/2017 “Per ndihmen juridike falas”

Ligji 18/2017 “Per te Drejtat dhe mbrojtjen e Femijes”

Ceshtja Bajrami kunder Shqipterise

Çështja Qufaj Co.sh.p.k. kundër Shqipërisë [Cm/Resdh(2011)86]

Arta Mandro, Revista Avokatia 6, 2013, Tirane

Denisa Daka, Revista Avokatia 12, 2017, Tirane

Shkresa Nr 22Prot. Dates 12.02.2019 i Zyres Permbarimore Sarande

Shkresa Nr. 99 Prot i Dt. 24.01.2019 i gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore

Shkresa e Dt. 28.01.2019 i Gjykates se rrethit Gjyqesor Sarande

Shkresa e Dt. 02.04.2019 e Gjykates se Apelit Vlore

Shkresa Nr. 91/1 Prot dt. 07.02.2019 Shkolla e Magjistratures